



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 538 Prot.

Roskovec, më 29.01 2020

VENDIM

NR 8 .DATË 24.01.2020

**“PËR NJË SHITESË TË LISTËS SË INVENTARIT, MIRATUAR ME VKM NR. 1210, DATË 11.12.2009
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE,
NË KOMUNËN KUMAN , TË QARKUT TË FIERIT ”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, gërma k); Ligjit Nr.8743, datë 31.07.2000 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar) neni 6, pika 2, gërma b); Ligjit Nr. 8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Ligji Nr.111/2018 “Për Kadastrën”, neni 2, gërma c, neni 69, pika 5, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 500, datë 14.08.2001 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), Udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr. 3, datë 18.07.2002 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, Vkm nr. 1210, datë 11.12.2009 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Kuman , të Qarkut të Fierit”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Të shtohet në listën e Inventarit të Pronave, prona me numër rendor 478, me nr. Pasurie 41/1 dhe indeks harte 215-A, Zyrat e Njësisë Administrative Kuman ,me sipërfaqe 428 m2(truall+ndërtesë).
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska

